



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/18/22

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Kryetarja e Gjykatës, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga pala A.B, ndaj gjyqtarit B.D , për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 29.04.2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga A.B ndaj gjyqtarit B.D, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Pala A.B ka ushtruar ankesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit B.D, e cila është pranuar në kompetencë nga Autoriteti i Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 05.04.2022. Me datë 15.04.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për pranimin e ankesës së parashtruesit. Me datë 22.04.2022 e njëjta ankesë është pranuar edhe përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Parashtruesi A.B ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtarit B.D për shkak të pretendimeve se, gjyqtari i çështjes ka hudhur padinë në lëndën C.nr.1958/11 pa kurrfarë baze juridike. Ka theksuar se, gjyqtari B.D i ka dhënë të drejtë një mashtrimi dhe padrejtësie, kur të gjitha faktet i ka pasur në anën e tij si paditës, edhe me marrëveshjen e ndërmjetësimit QN 504/3014. Ka shtuar se, pas mbajtjes së seancave gjyqësore, dhe plotësimit të ekspertizës financiare ishin pjekur të gjitha kushtet që vendimi të jetë i drejtë dhe në favorin e tij.

Në lidhje me pretendimet e parashtrueses të ankesës, gjyqtari i çështjes ka deklaruar, sa i përket lëndës në fjalë, me të njëjtën është ngarkuar me datë 03.03.2021, ka qenë lëndë e trashëguar nga gjyqtari A.K, lënda ka qenë në shqyrtim e sipër, e për të cilën janë mbajtur disa seanca, është nxjerrë një ekspertizë financiare, janë bërë disa plotësime të saj, ka pasur disa shtyrje të seancave për shkaqe procedurale, kryesisht vështirësive për kontakt me palën e paditur, ndërsa me datë 07.02.2022 është nxjerr Aktgjykimi. Ka shtuar se, në rastin konkret është refuzuar padia, sepse kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, ngase ankuesi në fjalë, lidhur me kërkesën e tij, ka një titull me të cilin i është njohur e drejta e pretenduar me një marrëveshje të arritur në procedurë të ndërmjetësimit me datë 30.12.2014, me nr. ref. i Gjykatës P.nr.963/2013, numri i referimit në ndërmjetësim Nr.QN.504/3014, e miratuar nga ana e Gjykatës Themelore në Prishtinë, me

vendimin e saj P.nr.963/2013 të datës 30.12.2014. Tutje gjyqtari i rastit ka theksuar se, sa i përket pretendimeve të palës ankuese të shprehura në ankesë për shkak të mënyrës së vendosjes, pretendimet e tilla nuk qëndrojnë, sepse deri te vendimi ka ardhur në bazë të provave dhe vlerësimit të lirë dhe objektiv, ku edhe ka dhënë arsyet se pse ka vendosur ashtu. Ka shtuar se, pas pranimit të lëndës, të njëjtën e ka trajtuar në një afat të arsyeshëm kohor, marrë parasysh faktin se lënda ishte në shqyrtim e sipër nga gjyqtari paraprak, dhe ai ka vazhduar me shqyrtimin e të njëjtës, ndërsa sa i përket mënyrës së vendosjes, arsyet janë dhënë në Aktgjykimin në fjalë.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtrueses së ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit B.D

Autoriteti i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka baza të arsyeshme për inicimin e hetimeve për shkelje disiplinore në veprimet e gjyqtarit B.D , lidhur me aktgjykimin e marrë, për të cilin pala është ankuar.

Lidhur me pretendimin e palës ankuese, se gjyqtari B.D ka qenë i njëanshëm në veprimet e tij, konkretisht me refuzimin e padisë, Autoriteti kompetent i kësaj gjykate vlerëson se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë sepse për aplikimin e gabuar të së drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtarit/ve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme në gjykatat e instancave më të larta nga pala e pakënaqur por nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore. Ndërsa sa i përket pretendimeve se gjyqtari i rastit nuk i ka trajtuar palët në mënyrë të barabartë, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme për t'i vërtetuar pretendimet e parashtruesit së ankesës, dhe për këtë Autoriteti Kompetent vlerëson se nuk është shkelur parimi i pavarësisë dhe paanësisë të përcaktuar me dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në lidhje me aktgjykimin e marrë, Autoriteti i kësaj gjykate vë në pah se nuk ka të drejtën e komentimit apo ndryshimit të vendimit të marr nga gjykata përkatësisht nga gjyqtari, sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtari vepron konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkuara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/18/22, me datë 29.04.2022

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë